

## **Mesazh nga z-nja Odre Azille, drejtoreshë e përgjithshme e UNESCO, me rastin e ditës Botërore të librit dhe të drejtës së autorit**

Librat prej kohësh kanë mishëruar aftësinë njerëzore për të krijuar botë, si reale ashtu dhe imagjinare, duke u dhënë zë përvojave të ndryshme njerëzore. Librat na ndihmojnë të ndajmë ide, të marrim informacion dhe të frymëzojmë admirim për kultura të ndryshme, duke mundësuar forma të gjera dialogu midis njerëzve në hapësirë dhe kohë.

Është e pamohueshme fuqia e librave për t'i dhënë njeriut ndjenjën e përplotësimit si dhe për të krijuar ndryshime shoqërore është i pamohueshëm. Autori i njohur nigerian, Chimamanda Ngozi Adiči, thoshte: "Të zgjedhësh për të shkruar do të thotë të refuzosh heshtjen".

Kjo është arsyeja pse UNESCO është e vendosur fort për të promovuar aksesin në libra dhe për ta nxitur leximin - për shembull, përmes programit tonë Kryeqyteti Botëror i Librit. Në vitin 2022, qyteti meksikan Guadalajara do të riemërohet Kryeqyteti Botëror i Librit, me një program njëvjeçar që fokusohet në rolin e librit dhe leximit në nxitjen e ndryshimeve shoqërore, luftimin e dhunës dhe ndërtimin e një kulture paqeje.

Pavarësisht rëndësisë së librave për ruajtjen e mirëqenies sociale, industria botuese aktualisht po përballlet me trazira të mëdha - mbi të gjitha me transformimin dixhital. Këto sfida u teksuan edhe më shumë sidomos gjatë KOVID-19, kur rënia e të ardhurave çënoi edhe autorët dhe librashitësit, si dhe profesionistët e tjerë kreativë në tërë zinxhirin e vlerës. Edhe diversiteti kulturor u kërcënuar ngjeshëm, meqë numri i titujve të botuar ra në mënyrë të pashmangshme.

Në kohë të pasigurta, ne duhet t'i vlerësojmë dhe mbrojmë librat si simbole të shpresës dhe të dialogut. Kjo do të thotë, të solidarizohemi me profesionistët që përhapin trashëgiminë tonë letrare - shkrimtarët, redaktorët, botuesit dhe përkthyesit. Gjatë ndërtimit të urave midis kontinenteve dhe kulturave, këta profesionistë duhet të mbrohen dhe të njihet vlera e tyre. UNESCO është e vendosur fort për këtë qëllim. Në një kohë kur teknologjia dixhitale po ndryshon industrinë e botimeve, ne po bëjmë presion për kompensim të barabartë për autorët dhe për mbrojtjen e diversitetit kulturor. Ne mbështesim punën e botuesve përmes aktiviteteve të tilla si: partneritetet me Forumin Ndërkombëtar të Autorëve, Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave dhe Institucioneve të Bibliotekave dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Botuesve.

Në Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, u bëj thirrje të gjithë partnerëve të UNESCO-s që të ndajnë mesazhin se librat janë një forcë që duhet llogaritur sot, për të kuptuar realitetet politike dhe ekonomike dhe për të luftuar pabarazitë dhe dezinformatat. Rrëfimi i tregimeve është një mjet tepër efektiv kur bëhet fjalë për edukimin e brezave të rinj.

Pa dyshim, librat janë një mjet jetik për për të arritur deri te transmetimi dhe promovimi i arsimit, shkencës, kulturës dhe informacionit anekënd botës. Për këtë arsye, çdo vit, më 23 prill - një datë që shënon largimin e tre autorëve të mëdhenj të letërsisë botërore, Miguel de Cervantes, William Shakespeare dhe Inca Garcilaso de la Vega - ne festojmë fuqinë e tyre magjike për të frymëzuar risi, për të gjeneruar njohuri dhe për të ndryshuar mënyrën e të menduarit.